

Test i Vlerave Olimpike

Ky është një test rreth vlerave Olimpike.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Grupi i synuar: Të rinjtë të moshës 12 vjec

Materiali: Kopjet bashkangjitur kuizit

Ndihmës : 1

Përmbledhje

Pjesëmarrësit ftohen të masin nivelin e tyre të "njohurive" rreth vlerave Olimpike, duke plotësuar një pyetësor në lidhje me reagimet e tyre në situata të ndryshme gjatë ditës dhe jetës. Më pas i gjithë grupi diskuton rreth rezultateve të pyetësorit të vlerave Olimpike.

Udhëzime

- Shpëndani nga një kopje të kuizit çdo pjesëmarrësi. Kërkojuni ta plotësojnë pyetësorin individualisht dhe lutjuni të jenë të sinqertë në përgjigjet e tyre.
- Pasi të gjithë të përfundojnë së plotësuari kuizin dhe kanë lexuar përgjigjet, filloni diskutimet mbi vlerat Olimpike në jetën e përditshme (në qoftë se ajo është hera e parë që ata dëgjojnë për to, atherë filloni duke prezantuar tre vlerat):
 - A ranë dakort pjesëmarrësit me përgjigjet e tyre? Pse?
 - Si mund të integrohen vlerat Olimpike të përsosmërisë, miqësisë dhe respektit, kur ata praktikojnë sportin? Po në jetën e përditshme? Çfarë mund të bëjnë ata më mirë?
 - Pse është e rëndësishme të konsiderohen të tre vlerat "si një e tërë" ? Cilat do të jenë pasojat në sport dhe në jetën e përditshme, në rast se respektohet vetëm njëra nga vlerat (p.sh. Përsosmëria) dhe harrojmë dy të tjerat?
 - Përse është e rëndësishme të respektohen këto vlera? Cilat janë pasojat e mosrespektimit? A mund të japim shembuj?

**Zgjidhni një opsion (A- B - C) për çdo pyetje
(Jini të sinqertë me përgjigjet tuaja!)**

1.

Ekipi juaj ka fituar ndeshjen me një diferencë të madhe.

- A Ju dhe shokët tuaj qeshni me humbësit.
- B Ju i thoni kundërshtarit se fati ishte me ju.
- C Ju përqëndroheni në ndeshjen e ardhshme. Kjo ndeshje nuk është më e rëndësishme.

2.

Ju keni humbur ndeshjen.

- A Ju mësuat shumë dhe betoheni se do të luani më mirë herën tjetër!
- B Ju fajësoni trajnerin, arbitrin, fushën, motin, ose prindërit tuaj!
- C Ju ndiheni fajtor se duhet të ishit stërvitur më shumë!

3.

Një shok i skuadrës ju tregon se ai është HIV – pozitiv.

- A Tani e tutje ju i mbani distancë.
- B Ju mendoni vërtetë se ai duhet të largohet nga klubi.
- C Ju pyesni atë se si mund t'i jepni mbështetjen tuaj.

4.

Ju keni për të luajtur një ndeshje hokej dhe dini se kundërshtarët janë mjaft agresivë. Çfarë duhet të bëjë ekipi juaj?

- A Luajmë me agresivitet si ata.
- B Mundohemi të negociojmë një ndeshje të luajtur drejt.
- C Luajmë ndeshjen tonë dhe besojmë arbitrin.

5.

Partneri juaj i ri në tenis është fëmija më jopopullor në klasë.

- A E konsideroni këtë si mundësi për ta njohur atë më mirë.
- B I kërkoni trajnerit për të ndryshuar partnerin.
- C Ju nuk thoni asgjë por talleni edhe më shumë pas shpine.

6.

Së bashku me mbështetës të tjerë ju vizitoni një derbi të basketbollit ndërkombëtar. Disa prej tyre fishkëllyen gjatë hymnit kombëtar.

- A Është qejf! Edhe ju merrni pjesë.
- B Është e turpshme dhe u flisni atyre.
- C Ju ndiheni të turpëruar dhe përpiqeni të largoheni nga ata.

7.

Në klubin tuaj një shok ngacmohet dhe tallet.

- A Ju nuk mund të bëni asgjë por shpresoni mos të jeni viktima e rradhës.
- B Ju vjen keq për mikun tuaj.
- C I kërkoni trajnerit në mënyrë që kjo të mos përsëritet.

8.

Konkursi po zhvillohet në një sallë gjimnastike shumë të vjetër.

- A Këtu apo kudo tjetër kjo nuk bën ndonjë ndryshim.
- B Ju gërvishni bojën për t'i treguar miqve se sa e vjetër është ajo.
- C Ju tregoni kujdes të veçantë që të mos dëmtohet asgjë.

9.

Ju luani tenis me vëllain tuaj më të vogël i cili është fillestar.

- A E lini të fitojë.
- B I jepni këshilla për progres.
- C Bukur shumë, kjo do të jetë një fitore e lehtë!



OLYMPIC DAY

Shkruani përgjigjet në faqen prapa për të llogaritur rezultatin tuaj.

Shkruani përgjigjet tuaja më poshtë për secilën nga pyetjet (A, B ose C) dhe llogaritni rezultatin tuaj.

1 2 3 4 5 6 7 8 9

	A	B	C
1	0	1	2
2	2	0	1
3	1	0	2
4	0	2	1
5	2	1	0
6	0	2	1
7	0	1	2
8	1	0	2
9	1	2	0

Rezultati im është:

- 0–5 pikë
 6–11 pikë
 12–18 pikë

Rezultati im është:

0–5 pikë

Ju nuk tregoni shumë miqësi apo respekt për njerëzit. Ndoshta ju mendoni se një shaka e pasjellshme është e pranueshme. Ju ndoshta nuk merrni gjithmonë respekt nga të tjerët. A e dini që ju respektoheni më shumë nëse ju tregoheni të respektueshëm?

Provojeni dhe mos harroni se vetërespekti është çelësi i suksesit !

6–11 pikë

Ju zakonisht i respektoni të tjerët. Ju gjithashtu pëlqeni më shumë disa njerëz se disa të tjerë dhe e tregoni këtë qartë. Ndoshta nuk ju intereson shumë gjendja apo situata e të tjerëve. Ju ndoshta e dini se duke treguar respekt merrni respekt. Mos e harroni këtë në jetën e përditshme!

12–18 pikë

Ju tregoni shumë respekt për njerëzit e tjerë. Kjo gjë është e natyrshme për ju. Ju nuk j'u pëlqejnë komentet e njëanshme. Ndoshta ju jeni shumë miqësor për këtë botë të vështirë. Mos harroni se nuk është e mundur të pëlqeheni nga të gjithë, ose të tregoheni gjithmonë të respektueshëm.

A jeni dakord me përgjigjet? Po Jo